



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Çështjet për Menaxhmentin e ATK-së për vitin 2019

Çështjet e mëposhtme nuk janë paraqitur në raportin e auditimit të ATK-së për vitin 2019, pasi që janë konsideruar si çështje të rëndësisë së ulët. Megjithatë, ne kemi përgatitur këtë dokument (letër për menaxhmentin), në të cilin kemi prezantuar këtë çështje dhe kemi dhënë rekomandimet për të përmirësuar menaxhimin e tyre. Nëse çështjet e njëjta përsëriten, do të raportohen në raportin final në periudhat e ardhshme.

Prishtinë, korrik 2020

Paga dhe mëditje

Çështja A: Procesi i Rekrutimit të Inspektorëve Tatimor në ATK

E gjetura

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil. ATK me datën 22.03.2019 kishte shpallur konkurs të jashtëm për rekrutim të 20 pozitave për inspektor tatimor.

Si rezultat i ekzaminimeve tona kemi vërejtur çështjet si në vijim:

Mos aplikimi i rregullores së MF Nr. 01/2015 për Rregullat dhe Procedurat e Rekrutimit, Zhvillimit, Transferimit dhe Shkarkimi i Stafit të ATK-së. Sqarime shtesë rreth mos aplikimit të Rregullores e MF për procesin e rekrutimit janë kërkuar nga Zyra Ligjore e ZKA-së. Konkursi i ATK-së ishte shpallur bazuar në rregulloren e MAP Nr. 02/2010 për procedurat e rekrutimit në shërbyes civil. Ne kemi kërkuar nga ATK, arsyen e mos aplikimit të kësaj rregullore dhe përgjigja e tyre përmes e-mailit (dt. 25.11.2019) ishte se MF ka shfuqizuar këtë rregullore. Po ashtu, kemi kërkuar edhe aktin e shfuqizimit të kësaj rregullore, por nuk kemi pranuar ndonjë përgjigje nga ana e tyre, përderisa sipas zyrës ligjore të ZKA-së, kjo rregullore është ende në fuqi.

Paraqitja e Kërkesave

Në konkursin e jashtëm të ATK- së të datës 22.03.2019 për inspektor tatimor të pjesa "paraqitja e kërkesave" ndër tjera kërkohet që aplikacionit duhet t'i bashkëngjitet dëshmia e përvojës së punës dhe dy referenca. Me rastin e vlerësimit të procesit të rekrutimit kemi vërejt se në dosjet apo aplikacionet e gjashtë (6) kandidateve nuk i kishin të bashkëngjitura referencat, (këta kandidat kanë rezultuar si të suksesshëm në procesin e rekrutimit dhe kanë nënshkruar Akt Emërimet për krijimin e marrëdhënies së punës në ATK).

Përvoja e punës

Nga gjithsej 20 kandidatët e përzgjedhur:

Në dy (2) raste, kandidatët përvojën e punës e kishin dëshmuar vetëm përmes trustit, në aplikacion apo dosje mungonin kontratat apo referencat që të sigurohemi cila është përvoja e punës profesionale, a ishte përvoja adekuate me kërkesat e paraqitura në konkurs.

Në një rast nuk kemi mundur të sigurohemi që kandidatja kishte përvojën e duhur profesionale, përvoja e kandidatës për marrëdhënie pune në aeroport nga viti 2006 pa e specifikuar pozitën që ka ushtruar, si dhe pas diplomimit ka përvojë si check-in agent për vitet 2009-2014.

Pagesa e Trustit për tri vite është bërë në një datë.

Në një rast kemi identifikuar se pagesa e trustit nga kompania për një kandidat sipas pasqyrës se trustit shihet se është bërë më 01.04.2019 për vitet 2016, 2017, 2018 dhe një pjesë të vitit 2019 prandaj komisioni edhe në këtë rast ka vlerësuar se kandidati i plotëson kriterin e përvojës dhe me ç'rast ka arritur pikët optimale për listë të ngushtë, në dosje nuk ka kontrate të marrëdhënies së punës, por vetëm letër referencë.

Akt Emërimet

Ky proces është karakterizuar me ankesa brenda ATK dhe në KPMSHCK, ku ATK pas shqyrtimit të ankesave i kishte refuzuar ankesat e kandidatëve si të pa bazuara. ATK me datën 08.08.2019 kishte drejtuar një kërkesë Kryetarit të Këshillit të Pavarur për Mbikëqyrjen e Shërbyesve Civil të Kosovës (KPMSHCK) që si të veprohet me akt emërimi në rastin e rekrutimit për inspektorë tatimor. Kryetari i KPMSHCK-së me datën 19.08.2019 i përgjigjet Drejtorit të Përgjithshme të ATK-së se ky institucion nga data 21.01.2019 është tërësisht jo funksional për shkak të mungesës së kuorumit për marrjen e vendimeve, por se ATK mund të bëjë emërimin e kandidatëve me qëllime që mos të shkaktohen probleme në funksionimin e ATK.

ATK me datën 28.08.2019 pas përgjigjes së pranuar nga Kryetari i KPMSHCK-së kishte nënshkruar aktet emërimet për pozitën inspektor tatimor periudhë provuese në kohëzgjatje prej dymbëdhjetë (12) muaj. Meqenëse kuorumi në KPMSHCK nuk është kompletuar, si rrjedhojë ankesat e kandidatëve vazhdojnë të mbesin të pashqyrtuara. Inspektorët kanë themeluar marrëdhënie pune dhe vazhdojnë të punojnë në ATK.

Ndikimi

Në pikëpamjen tonë, procesi i rekrutimit është përcjellë me shumë paqartësi, parregullsi dhe anashkalim të procedurave. Kjo dëmton seriozisht kredibilitetin e procesit dhe ngrit dyshime nëse është pranuar stafi më i mirë dhe kompetent në detyrat e inspektorëve, përderisa mundësia e zgjedhjes ishte mjaft e madhe.

Rekomandimi 1

Menaxhmentin e ATK-së që të vazhdoj procedurat e shqyrtimit bashkë me KPMSHC dhe pas shqyrtimeve të përbashkëta, të nxjerrë konkluzionet dhe vendimet përfundimtare lidhur me rregullsinë e procesit dhe të merr masat përmirësuese nëse kjo kërkohet nga KPMSHC.